



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2022

Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 21/06/2022

Drejtuar: “DRINI A” SH.P.K, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe-Shkoder km I-re, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Mallra

Numri i procedurës/ referenca e Lotit: REF-30908-05-26-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje e materialeve per mirembatjen e Godinave Arsimore, ne administrim te Bashkise Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te marreveshjes Kuader.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “DRINI A” SH.P.K, me Nuis J67902505V dhe me oferte ekonomike 13,867,800 (trembedhjete milion e teteqind e gjashtedhjete e shtate mije e teteqind) Lek pa TVSH,
- 2- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T dhe me oferte ekonomike 11,925,920 (njembdhjete milion e nenteqind e njetzet e pese mije e nenteqind e njetzet) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, Nuis J87603505T.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.4, ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar per mallrat sipas tabelës së mëposhtme. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.*

Nr	Emertimi i mallit
1	Llaç I gatshëm
2	Fino
3	Koll per pllaka
4	Katrama 4 mm, me granil
5	Praim
6	Boje hidroplastike Cilesi e I-re.
7	Boje Hidromat
8	Prizë shuko
9	Panel ndriçimi led 60 x 60cm (me suport)
10	Automat monofaze 20 A
11	Salvavita 40A 1F,2P
12	Automat 3 fazor 63A
13	Automat 25A 1F,1P
14	Kabull Φ (2 x2.5)
15	Çeles elektrik
16	Tel 1 x 2.5mm

Komisioni i Vleresimit të Ofertave verën se për plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin/ marrëveshjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar për mallrat e kerkuara në pikën 2.3.4. Në rast se paraqesin autorizim/marrëveshje distributori zyrtar duhet të bashkëngjisin edhe autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi në SPE rezulton se për mallrat “Prizë shuko, Panel ndriçimi led 60 x 60cm (me suport), Automat monofaze 20 A, Salvavita 40A 1F,2P, Automat 3 fazor 63A, Automat 25A 1F,1P, Kabull Φ (2 x2.5), Çeles elektrik, Tel 1 x 2.5mm”, operatori ekonomik ka paraqitur autorizim nga një operator (furnizues), i cili pretendon se është distributor i materialeve elektrike, por nga verifikimi i dokumentacionit nuk provon që është distributor i autorizuar nga prodhuesi, pasi në autorizimin e paraqitur mungojnë të dhëna të prodhuesit (emer, numer nipti, adrese, etj.), si dhe nuk ka bashkëngjitur asnjë dokumentacion që provon lidhjen me prodhuesin për të cilin pretendon se është distributor.

Nisur sa më lart duke qenë se subjekti i cili ka leshuar autorizimin për mallrat elektrike nuk provon që është distributor i autorizuar nga prodhuesi, si dhe nuk ka bashkëngjitur asnjë dokumentacion që provon lidhjen me prodhuesin për të cilin pretendon se është distributor, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.6, ku parashikohet se: *“Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

- *Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:*

1	<i>Panel ndriçimi led 60 x 60 cm (me suport)</i>
2	<i>Automat monofaze 20 A</i>
3	<i>Salvavita 40A 1F,2P</i>
4	<i>Automat 3 fazor 63A</i>
5	<i>Kabull Φ (2x2.5)</i>
6	<i>Çeles elektrik</i>

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë magazines se Drejtorise se Sherbimeve Publike, te Bashkise Lezhe me adrese: Rruga “Vellezerit Coku”, Ish SMT, Lezhe.*
- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara*

,pasi bazuar ne procesverbalin Nr. 01, date 13/06/2022, i mbajtur midis Komisionit te Vleresimit te ofertave dhe Operatoreve Ekonomik te pranishem gjate zhvillimit te procedures per dorezimin e mostrave dite dhe oren e hapjes se ofertave, Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, nuk eshte paraqitur per te dorezuar mostrat per artikujt e kerkuar ne DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “STELLA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “STELLA” SH.P.K, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “DRINI A” SH.P.K, me adresë Lagjja “Nen Tereza”, godina në rrugën nacionale Lezhe-Shkoder km I-re, në zonën kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13,867,800 (trembedhjete milion e teteqind e gjashtedhjetë e shtatë mijë e teteqind) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/ 2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU**
